12/06/2026

Dibër/Kishte Kultivuar 300 Bimë Narkotike Dhe Ishte I Armatosur, Arrestohet 43-Vjeçari

Dibër

Kishte kultivuar 300 bimë narkotike kanabis në një zonë të pyllëzuar dhe i ruante i armatosur, falë veprimeve të mirëorganizuara policore kapet dhe vihet në pranga autori.

Sekuestrohet arma e zjarrit me të cilën ruante parcelën dhe asgjësohen 300 bimë të dyshuara narkotike Cannabis Sativa.

Në zbatim të masave të ndërmarra në kuadër të planit operacional për parandalimin dhe goditjen, që në fazë fillestare, të tentativave për kultivimin e bimëve narkotike, shërbimet e Komisariatit të Policisë Dibër, në bashkëpunim me strukturat e DVP Dibër dhe Forcën e Posaçme "Shqiponja", bazuar edhe në informacionet e siguruara në rrugë operative për një shtetas nga Tirana, i cili kultivonte bimë narkotike në fshatin Guri i Zi dhe i ruante ato i armatosur, kanë organizuar punën për goditjen e kësaj veprimtarie kriminale.

Si rezultat, në një zonë të pyllëzuar të fshatit Guri i Zi, Bashkia Dibër, shërbimet e Policisë kanë ndërhyrë dhe kanë arrestuar në flagrancë shtetasin L. M., 43 vjeç, banues në Tiranë, i cili u kap me armë zjarri (pushkë), në ambientin ku kishte kultivuar 300 bimë të dyshuara narkotike Cannabis Sativa.

Arma e zjarrit (pushkë), së bashku me 6 fishekë, u sekuestrua në cilësinë e provës materiale, bashkë me një pjesë të bimëve të dyshuara narkotike, ndërsa pjesa tjetër u asgjësua me anë të djegies.

Në vijim të veprimeve për këtë rast, nisi procedimi penal në gjendje të lirë për shtetasin H. Sh., me detyrë kryetar i fshatit Guri i Zi, i dyshuar për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës".

Operacioni antikanabis vijon.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për veprime të mëtejshme.

DVP Tiranë/Njoftim

REZULTATET KRYESORE TË STRUKTURAVE POLICORE NË VEND DHE NGJARJET E NDODHURA GJATË 24 ORËVE TË FUNDIT

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent

Copyright © 2026 Policia e Shtetit. All rights reserved. Theme: ColorNews by ThemeGrill. Powered by WordPress.